

# AKT THEMELIMI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “ BISTRICA 4 ENERGY ” SH.P.K.

Sot më datë 02.02.2018 në Tiranë, themeluesi

Shoqëria **BISTRICA 3 Sh.p.k.** regjistruar si person juridik me vendimin Nr 35495 date 18.04.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli qendrore administrative Rruga “Industriale” Nd.3, Mucaj, Vore, Bashkia Vore, 1053, Qarku Tiranë, regjistruar ne Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me Nipt K72230029K datë 01.11.2007 , me Përfaqesues Ligjor, Administrator z. Viktor Hykollari

Bazuar në legjislacionin aktual në fuqi,

- Ligji Nr 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar, vecanërisht në nenet 68 e vijues te tij,
  - Ligji nr 131/2015 “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar
  - Ligji nr 9723 date 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare Regjistrimit” i ndryshuar,
  - Ligji nr 9663 date 18.12.2006 “Për Koncesionet” i ndryshuar ,
  - VKM nr 711 date 21.05.2008 “Për Miratimin e Kontratës së Konçesionit,të formës “BOT”,te lidhur midis Ministrise se Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes dhe shoqërisë Bistrica 3 Shpk për ndërtimin e hidrocentraleve Bistrica 3 e 4” ,
- për zbatimin sa më mirë të kontratës koncesionare Nr 1106 Rep, Nr 193 Kol, datë 19.05.2008, të miratuar me VKM nr 711 date 21.05.2008

si **Ortak i Vetëm** vendosi krijimin e shoqërisë **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.**, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve që vijnë :

#### Neni 1

1.1.Krijohet shoqëria tregëtare **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** me qëllim zbatimin sa me drejtë të kontratës së konçesionit të formës BOT ( ndërtim-operim-transferim) të

hidrocentralit **Bistrica 4** të ndodhur mbi lumin Bistricë, me vendndodhje Aliko, Bashkia Finiq, Rrethi Sarandë, Qarku Vlorë, ku do të ushtrohet aktiviteti ekonomik.

Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe do të përdoret në të gjithë regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.

1.2.Shoqëria **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** është e formës ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.3.Shoqëria ka vulën e saj identifikuese, në formë të rumbullakët në të cilën është shkruar **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** Vula e shoqërisë mund të ndryshoje vetëm me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të Vetëm **BISTRICA 3 Sh.p.k.**



## Neni 2

2.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** në përputhje me legjislacionin aktual tregëtar shqiptar do të jetë:

➤ Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentralit Bistrica 4 me fuqi të instaluar 1,335 kW, prodhim i energjisë elektrike 10.902.000 kWh tek Autoriteti Kontraktues (MEI) konforme termave dhe kushteve të kontratës brenda së cilës përfshihet : **financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hec-it Bistrica 4 , prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike**

në zbatim të kontratës koncesionare Nr 1106 Rep, Nr 193 Kol, datë 19.05.2008, të miratuar me vendimin e KM Nr 711 datë 21.05.2008. "Për Miratimin e Kontratës së Koncesionit, të formës "BOT", të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë Bistrica 3 Shpk për ndërtimin e hec-ve Bistrica 3 e 4",

## Neni 3

3.1. Selia qendrore , administrative e shoqërisë **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** do të jetë në Republikën e Shqipërisë me adresë :

Rruga "Industriale", Nd.3, Muçaj, Vorë, Bashkia Vorë, 1053, Qarku Tiranë.

3.2. Shoqëria **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në prodhimin e energjisë elektrike me vendodhje me Aliko, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë për një periudhë 35-vjeçare.

## Neni 4

Kapitali aksionar i shoqërisë është kontribut i Ortakut të Vetëm **Bistrica 3 Shpk.** të investuara në emër të shoqërisë **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** si më poshtë :

- 1 kuote me vlerë kapitali 50.000.000 (Pesëdhjetemilion) Lekë,
- Nr pjesëve 1
- Pjesëmarrje 100% në kapitalin aksionar.

Kapitali i shoqërisë është shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm **Bistrica 3 Shpk.**

## Neni 5

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me dispozitat e këtij akt themelimi, të statutit të miratuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakut të Vetëm **Bistrica 3 Shpk** , që i bashkëngjitet këtij Akt Themelimi mbështetur në legjislacionin shqiptar aktual në fuqi.

## Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë **BISTRICA 4 ENERGY Sh.p.k.** në prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme kufizohet në një afat 35-vjeçar dhe mund të zgjatet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë **Bistrica 3 Shpk** dhe miratim të Autoritetit Kontraktues siç është percaktuar në kontratën e koncesionit dhe të miratuar në VKM nr 711 datë 21.05.2008.

## Neni 7

7.1. Në përputhje me nenin 9.1. të statutit të shoqërisë së krijuar, themeluesi vendosi **Përfaqësues Ligjor, Administrator** të emëroje z. **Sazan Bajram Piro**, me kartë ID G20404196W, lindur në 04.04.1962 në Sarandë, banues në Tiranë, Rr.....

7.2. Afati i përfaqësimit të tij fillon me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit për një kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

## Neni 8

Përfaqësuesi Ligjor, Administratori i shoqërisë gëzon të drejta të plota në marrëdhëniet e shoqërisë me të tretët dhe të punësuarit dhe përsa i përket drejtimit të shoqërisë, gjithmonë brenda kufijve të lejueshëm nga statuti i shoqërisë dhe nga legjislacioni shqiptar aktual në fuqi dhe nga vendimet e Ortakut të Vetëm.

## Neni 9

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjashtimisht ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit gjer më 31 dhjetor.

## Neni 10

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të saj, e cila me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, i merr përsipër këto shpenzime si detyrime të saj dhe do të përfshihen në bilancin e saj.

Pjesë e pandare e aktit të themelimit është statuti i shoqërisë, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm **BISTRICA 3 Sh.p.k.**

## Neni 11

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve midis ortakëve dhe interpretimin e statutit të shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


## N Ë N S H K R U E S I T

### ORTAKU I VETËM

## BISTRICA 3 SHPK

### ORTAK

zotërues, me përqindje pjesëmarrje  
në masën 83 % të kapitalit



### ORTAK

zotërues, me përqindje pjesëmarrje  
në masën 17 % të kapitalit

